

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7938
E shtunë, 23 nëntor 2024
Çmimi 0.50 €

Hamza për Thaçin dhe Veselin: Mungesa e tyre ka qenë një goditje e madhe për PDK-në | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KATËR VJET NGA MARRËVESHJA E UASHINGTONIT, HOTI: KOSOVA S'KA ARRITUR TË IMPLEMENTOJË PROJEKTE TË RËNDËSISHME. | **FAQE 4-5**



Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se për katër vjet Kosova nuk ka arritur të implementojë projekte të rëndësishme që dalin nga marrëveshja e Uashingtonit të cilën e kishte nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë. Hoti ka

vlerësuar se implementimi i kësaj marrëveshjeje do të kishte impakt në ekonominë e Kosovës. Gjatë kohës sa ka qenë kryeministër, Hoti ka thënë se ka punuar me aleatët në mënyrë që Kosova të ecë përpara sa i përket integritetit si

dhe të arrihet marrëveshja përfundimtare me Serbinë. Hoti ka thënë se nuk po duket që në të ardhmen e afërt mund të arrihet një marrëveshje me Serbinë andaj, sipas tij, duhet të fokusohen në ekonominë e vendit

KURTI: SYNIM I SERBISË MBETET HAKMARRJA, KOSOVA DUHET TË JETË E PËRGATITUR PËR KËTË | **F. 7**



SHQIPËRIA: PASIVIZIMI I ADRESAVE TË SHQIPTARËVE NË LUGINË, SHKELJE E TË DREJTAVE TË NJERIUT | **F. 8**



DOSSIER

KONGRESI I MANASTIRIT - KONGRESI I ABC-së
Sipas dokumenteve arkivore të Austro-Hungarisë



Shkruan: Prof. dr. Eqrem ZENELAJ

AKTUALE



SHQIPJA NË MAQEDONINË E VERIUT: ÇFARË PO E PENGON ZBATIMIN E LIGJIT PËR GJUHËT? | **F. 4**

HARADINAJ: KOSOVA KA NEVOJË PËR NJË MENDËSI TË RE QEVERISËSE, TË BASHKOHEMI PËR KOSOVËN FITUESE | **F. 7**

BE-JA PRET QË KOSOVA TË BËJË HAPA KONKRETË NË ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BRUKSELIT | **F. 3**

EKONOMI



HEKURUDHA DURRËS - PRISHTINË, ALIU: KOSOVA FINANCON PJESËN E VET, POR NUK ËSHTË LIDERE E PROJEKTIT | **F. 8**

HAMZA: NE JEMI ADRESA E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË DHE EKONOMISË SË KOSOVËS | **F. 8**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Magowan: Trupat britanike, të 'gatshme' të luftojnë me ushtrinë ruse

LONDËR, 22 NËNTOR - Zëvendëskreu i ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar, Rob Magowan, ka thënë se trupat britanike janë gati të luftojnë me forcat e Vladimir Putinit

nëse Rusia do ta niste pushtimin e një vendi tjetër evropian pas Ukrainës. "Unë nuk mendoj se dikush duhet të mendojë se nëse rusët do të pushtonin Evropën Lindore

sonde, ne nuk do të luftonim", ka deklaruar ai. Deklarata e Magowan ka ardhur disa orë pasi ambasadori rus në Mbretërinë e Bashkuar, Andrei Kelin, ka

paralajmëruar se përdorimi i raketave "Storm Shadow" nga Ukraina në territorin rus do të thotë se Britania "tani është e përfshirë drejtpërdrejt në këtë luftë".



Trumpi zgjedh Pam Bondin për prokurore të përgjithshme të ShBA-së

Uashington, 22 nëntor - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka njoftuar se do ta nominojë Pam Bondin për t'u emëruar prokurore e Përgjithshme e vendit, pak orë pasi Matt Gaetz është tërhequr nga gara.

Bondi, e cila ka qenë mbështetëse e zëshme e Trumpit, ka përvojë të gjatë në sundimin e ligjit dhe në të kaluarën ka shërbyer prokurore e Përgjithshme e Floridës. Ajo ka qenë pjesë e ekipit mbrojtës të Trumpit gjatë gjykimit të parë kundër tij, ku ai akuzohej se i kishte bërë trysni Ukrainës të kryente hetim për korrupsion kundër rivalit të tij, presidentit të tanishëm amerikan Joe Biden, duke e bllokuar ndihmën ushtarake. Trumpi u shpall i pafajshëm për këto akuza më vonë nga Senati.

Së voni, Bondi ka ndihmuar në udhëheqjen e krahut ligjor të

Institutit për Politika "America First", një organizatë personeli i së cilës ka punuar ngushtë me fushatën e Trumpit për të ndihmuar në ndryshimin e politikave për administratën e tij të ardhshme.

Bagazhi i Bondit dallon shumë me atë të Gaetzit, i cili ka shumë pak përvojë tradicionale për një prokuror të përgjithshëm, dhe i cili pritej të përballej me kundërshtim nga demokratët në Senat dhe nga disa republikanë, po ashtu.

Trumpi ka njoftuar në rrjetet sociale se e ka zgjedhur Bondin, duke e lartësuar atë për përvojën e saj në prokurori dhe duke thënë se ajo është e ashpër ndaj krimeve si prokurorja e parë e përgjithshme grua e Floridës.

Trumpi, i cili ka fituar zgjedhjet më 5 nëntor, pavarësisht se përballej më shumë hetime penale nga prokurorët shtetërorë dhe



amerikanë, ka thënë se Bondi do t'i japë fund politizimit të prokurorisë federale.

"Për kohë të gjatë, Departamenti i Drejtësisë i njëanshëm është armatosur kundër meje dhe

republikanëve të tjerë. Por, jo më", ka thënë Trumpi.

Ndërkohë, Matt Gaetz, ka njoftuar më herët se është tërhequr nga nominimi për postin e prokurorit të Përgjithshëm të Shteteve të

Bashkuara. Ai ishte nominuar nga Trumpi, por ka thënë se këtë vendim për t'u tërhequr e ka marrë për shkak të një hetimi federal kundër tij për trafikim të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual.

NATO thotë se raketa eksperimentale balistike ruse nuk do ta lëkundë mbështetjen e aleancës për Ukrainën



BRUKSEL, 22 NËNTOR - Presidenti i Ukrainës, Volodimir Zelensky, ka theksuar se përdorimi nga Rusia i një raketë eksperimentale balistike përbën një "përshkallëzim të qartë dhe serioz" të luftës dhe ka bërë thirrje për një reagim të fuqishëm nga bota. Ai e ka akuzuar presidentin rus Vladimir Putinin për përpjekjet që t'i "terrorizojë" civilët dhe t'i frikësojë aleatët e Ukrainës.

Ndërsa zëdhënësi i NATO-s, Farah Dakhllallah, ka thënë se "kjo nuk do ta ndryshojë rrjedhën e konfliktit dhe nuk do t'i largojë aleatët e NATO-s nga mbështetja për Ukrainën". Pas fjalimit të Putinit për sulmin në një vend ushtarak në qytetin Dnipro, Zelensky është shprehur se sulmi ishte një "dëshmi tjetër që Rusia nuk është e interesuar për paqe". Ai ka thënë se është i domosdoshëm "presioni" mbi Rusinë dhe se "rusët duhet të

detyrohen të pranojnë një paqe të vërtetë, që mund të arrihet vetëm me forcë".

Nga ana tjetër, presidenti rus ka kërcënuar me sulme të tjera, duke deklaruar se Moska ka "të drejtë" t'i godasë vendet perëndimore që i kanë furnizuar Ukrainës armë për t'i sulmuar objektivat në Rusi. Ndryshe, Rusia ka nisur pushtimin e shtetit ukrainas më 24 shkurt të vitit 2022 duke shkaktuar mijëra viktima dhe dëme të shumta materiale.

Kim Jong Un: Kurrë nuk kemi qenë më afër luftës bërthamore

Penjan, 22 nëntor - Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, ka thënë se Gadishulli Korean nuk ka qenë kurrë paq afër një lufte bërthamore pas atyre që ai i ka përshkruar si lëvizje "agresive"

në veçanti nga ShBA-ja. "Asnjëherë më parë palët ndërluftuese në Gadishullin Korean nuk janë përballur me një konfrontim kaq të rrezikshëm dhe të mprehtë sa të mund të përshkallëzohej në

luftën më shkatërruese termonukleare. Ne tashmë kemi shkuar aq larg sa mundemi në negociatat me Shtetet e Bashkuara, por ajo për të cilën u bëmë të sigurt nga rezultati nuk është

gatishmëria e superfuqisë për të bashkëjetuar, por qëndrimi i saj i plotë i fuqisë dhe politika agresive dhe armiqësore ndaj nesh që nuk mundet kurrë", ka thënë Kim, sipas agjencisë shtetërore të lajmeve "KCNA".



Katër vjet nga marrëveshja e Uashingtonit, Hoti: Kosova s'ka arritur të implementojë projekte të rëndësishme

Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se për katër vjet Kosova nuk ka arritur të implementojë projekte të rëndësishme që dalin nga marrëveshja e Uashingtonit të cilën e kishte nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë. Hoti ka vlerësuar se implementimi i kësaj marrëveshjeje do të kishte impakt në ekonominë e Kosovës. Gjatë kohës sa ka qenë kryeministër, Hoti ka thënë se ka punuar me aleatët në mënyrë që Kosova të ecë përpara sa i përket integritetit si dhe të arrihet marrëveshja përfundimtare me Serbinë. Hoti ka thënë se nuk po duket që në të ardhmen e afërt mund të arrihet një marrëveshje me Serbinë andaj, sipas tij, duhet të fokusohen në ekonominë e vendit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka mbajtur tryezë diskutimi lidhur me katërvjetorin e marrëveshjes historike për normalizim ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga presidenti Donald Trump.

Ish-kryeministri Avdullah Hoti, i cili atë kohë kishte nënshkruar marrëveshjen, ka thënë se, ndonëse kanë kaluar mbi 4 vjet nga arritja e marrëveshjes, Kosova ende nuk ka arritur të implementojë projekte të rëndësishme të cilët do të kishin impakt në ekonominë e vendit.

Gjatë kohës sa ka qenë kryeministër, ai ka thënë se ka punuar me aleatët në mënyrë që Kosova të ecë përpara "sa i përket integritetit si dhe të arrihet marrëveshja përfundimtare me Serbinë".

Hoti ka thënë se nuk po duket që në të ardhmen e afërt mund të arrihet një marrëveshje me Serbinë andaj, sipas tij, duhet të fokusohen në ekonominë e vendit.

"Ne kemi punuar ngushtë me aleatët që çështja e Kosovës të jetë sfidë për integritet euroatlantik e jo sfidë e sigurisë. Tash kam frikë se gjatë këtyre viteve jemi kthyer prapë në pikën zero ku Kosova trajtohet në tavolinat e aleatëve si problem i sigurisë. Nuk ka më dialog për njohje reciproke. Është arritur një marrëveshje në Bruksel dhe një aneks në Ohër. Sot në vitin 2024 besoj se do të duhej të ishim në kulm të investimeve edhe në hekurudhë edhe në autostrada edhe në krijimin e portit në dalje të Prishtinës dhe më vjen shumë keq që nuk kemi avancuar në projektin e gazit. Këto projekte nuk janë anuluar, por kemi humbur kohë shumë të vlefshme. Unë besoj që pas zgjedhjeve të ardhshme t'i kthehemi kësaj agjende. Ne nuk po duket që në të ardhmen e afërt mund të arrijmë një



marrëveshje me Serbinë, andaj duhet të fokusohemi në ekonominë e vendit", ka thënë Hoti.

Më tutje, Hoti ka thënë se beson që administrata e re e Trumpit do të ketë qasje më pragmatike ndaj dialogut Kosovë - Serbi. "Unë hezitoj t'i interpretoj politikat e presidentëve amerikanë. Se si do të qaset tani presidenti i ri karshi dialogut Kosovë - Serbi po tentoj të besoj që do të shohim një qasje shumë më pragmatike. Unë nuk besoj që kjo qasje mund t'i cenoj arritjet që i kemi deri më tani. Kjo nënkupton që të shtyhen të dy palët që të hyjnë në aranzhime që e ndërrojnë qasjen e

dy vendeve në arritjen e marrëveshjes përfundimtare", ka thënë Hoti.

Ndërsa drejtori i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se kjo odë gjatë këtyre viteve ka vazhduar t'i mbështesë dispozitat e marrëveshjes së Uashingtonit. "Si asnjëherë tjetër nuk ka ndodhur që një marrëveshje e tillë të ndërmjetësohet nga ShBA-ja dhe të nënshkruhet në njërin prej institucioneve të rëndësishme. Jemi krenarë që Oda Amerikane edhe në atë kohë edhe përgjatë këtyre viteve ka vazhduar t'i mbështesë dispozitat e marrëveshjes së Uashingtonit. Oda

Ekonomike është duke organizuar aktivitete për t'i përafuar bizneset e Kosovës me ato të Serbisë. Ne synojmë dhe besojmë që katër liritë janë të mundshme dhe mbajmë qëndrim optimist sa i përket të ardhmes së këtyre katër liritë", ka thënë Zeka.

Por, gazetari Adriatik Kelmendi ka theksuar se Kosova aktualisht ndodhet në pikën më të ulët të marrëdhënieve me aleatët. "Atëherë kishte optimizëm. Kishte një proces që kishte hyrë në kanalet e veta. Ishte procesi që udhëhiqej nga Brukseli. Ne sa herë që shihnim se procesi mund të merrte ndonjë kahe ne më

së shumti thoshim se na duhet përfshirja e drejtpërdrejtë amerikane. Atëherë kishte optimizëm se një marrëveshje përfundimtare mund të ishte më afër sesa që shihet sot. Ne jemi fituesit e asaj çfarë ka ndodhur. Por Serbia është aleate më e madhe ekonomike për shtetet e tjera sesa Kosova", ka thënë Kelmendi, duke shtuar se kjo është dëm për Kosovën. Sipas tij, rëndësia ekonomike nuk mund të ndahet nga politika. "I vetmi shtet i cili nuk e sanksionon Rusinë, por përfiton gjatë gjithë kësaj kohe, është Serbia", ka thënë Kelmendi.

BE-ja pret që Kosova të bëjë hapa konkretë në zbatimin e marrëveshjes së Brukselit

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Bashkimi Evropian pret që Kosova ta zbatojë Marrëveshjen e Brukselit në përputhje me deklaratat e kryeministrit Albin Kurti.


Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka deklaruar se tani Kosova duhet të bëjë veprime konkrete në zbatimin e marrëveshjes me Serbinë. "Ne mirëpresim gatishmërinë e deklaruar të Kosovës për të filluar zbatimin e Marrëveshjes për Rrugën e

Normalizimit, kërkojmë që të përputhet deklarata me veprime konkrete dhe të fillojë ta bëjë këtë menjëherë. Si Kosova ashtu edhe Serbia duhet t'i zbatojnë të gjitha obligimet e tyre të dialogut pa ndonjë vonesë të mëtejshme apo vendosjen e parakushteve të reja në mënyrë që të bëjnë përparim në rrugën e tyre përkatëse evropiane", ka thënë Stano për "RTV21".

Ai ka përsëritur se moszbatimi i

kësaj marrëveshjeje do të ndikojë në rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. "Dështimi për të zbatuar atë që është rënë dakord do të ndikojë në aftësinë e tyre për të avancuar në aspiratat e tyre evropiane. BE-ja është lehtësuese e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe jo palë në marrëveshje", është shprehur Stano.





Shqipja në Maqedoninë e Veriut: Çfarë po e pengon zbatimin e Ligjit për Gjuhët?

Shkup, 22 nëntor - Historia e rregullimit të përdorimit të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut është më e vjetër se Kushtetuta e vendit. Le të kthehemi mbrapa në kohë. Para Kushtetutës së vitit 1991, në atë që sot njihet si Maqedoni e Veriut, parashihehin të drejta për shtetasit e të gjitha kombësive që jetonin brenda shtetit. Por, më 1991 pati përpjekje për të krijuar një Kushtetutë me fokus në shtet-komb, ndërsa gjuha maqedonase, me alfabetin e vet cirilik, u përcaktua gjuhë e vetme zyrtare. Diçka e tillë rezultoi e papërshtatshme për një shtet shumëkombësh sikurse Maqedonia e Veriut. Kësaj, përdorimi i gjuhës shqipe dhe aspekte të tjera, si përdorimi i simboleve kombëtare, përfaqësimi në Parlament dhe në institucione të tjera, patën nxitur konflikt të armatosur më 2001, mes shqiptarëve dhe maqedonasve, i cili përfundoi me Marrëveshjen e Ohrit. Me këtë Marrëveshje, Kushtetuta u ndryshua përmes 15 amendamenteve, të cilat rregulluan edhe përdorimin e gjuhëve të tjera në vend, përveç asaj maqedonase. U vendos që gjuhë zyrtare në Maqedoninë e Veriut janë

gjuha maqedonase dhe gjuhët e tjera që fliten nga mbi 20 për qind e qytetarëve të vendit. Kështu, shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera iu dha mundësia e integritimit në shoqëri.

Rregullimi i përdorimit të shqipes

Sipas regjistrimit të popullsisë më 2022, Maqedonia e Veriut i ka rreth 2 milionë banorë, nga të cilët 54 për qind janë maqedonas, 29 për qind shqiptarë, ndërsa pjesa tjetër janë pjesëtarë të komuniteteve më të vogla. Përdorimi i gjuhës shqipe është rregulluar ndërkohë edhe me ligje të tjera, përfshirë një të vitit 2008, ndonëse ai, sipas njohësve të drejtësisë, përfshinte një interpretim të ngushtë. Ligji i ri, ai për përdorim të gjuhëve, i shumëpërfolur vitet e fundit, i cili nisi të diskutohet qysh më 2017 dhe u miratua më 2018, parasheh përdorim të zgjeruar të gjuhës shqipe, dhe e përmend atë në mënyrë specifike në nenin 2. Ndryshimet kryesore që solli ligji i ri ishin: përdorimi i gjuhës shqipe edhe në procese gjyqësore, në bankënota dhe në uniforma policore. Partia VMRO-DPMNE, e cila më 2018 ishte në opozitë, ndërsa sot në

pushtet, e kundërshtoi ashpër miratimin e ligjit, nuk mori pjesë në votim dhe e dërgoi këtë dokument menjëherë në Gjykatën Kushtetuese. Përveç Ligjit për Gjuhët, në gjykatë u paraqitën edhe konteste të tjera dhe, tani, të gjitha ankesat e parashtruara, 13 sosh, pritet të marrin epilog me një vendim që do të bëhet publik në dhjetor. Profesoresha e së Drejtës në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut, Besa Arifi, nuk shpreh shumë optimizëm për vendimin që do të merret. “Duke u nisur nga vendimi paraprak që e sollën për ‘Balancuesin’, nuk besoj se do të jenë tërësisht objektive sepse, sa shoh unë, qëllimi është të interpretohen në mënyrë restriktive të drejtat që dalin nga marrëveshjet e kaluara”, thotë ajo për “Radion Evropa e Lirë”. “Balancuesi”, tashmë i shfuqizuar, ishte një mekanizëm që rregullonte përfaqësimin “e drejtë dhe adekuat” të komuniteteve në institucionet shtetërore në këtë vend.

Pse kundërshtohet Ligji për Gjuhët?

VMRO DPMNE-ja e ka kundërshtuar vazhdimisht

ligjin dhe është zotuar se do të bëjë “korrigjime” kur ta fitojë pushtetin. Disa besojnë se ndërkohë janë ndërtuar narrativë se shqiptarët kanë siguruar më shumë të drejta sesa u takojnë. Së fundmi, kryeministri maqedonas Hristijan Mickoski ka thënë se nuk po kontestohet i gjithë ligji, por “vetëm dy-tri dispozita”. Disa besojnë se ai po aludon në gjyqësor, në bankënota dhe në uniforma.

Qëndrimet e palëve të tjera

Kreu i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI) në opozitë, Ali Ahmeti, ka shprehur shqetësim për, siç ka thënë, “rrezikim të arritjeve historike të shqiptarëve”, dhe për këtë u ka nisur letër edhe krerëve të shteteve perëndimore. Partia e tij e ka konsideruar “të pavërtetë dhe të papranueshme” edhe deklaratën e fundit të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, lidhur me Ligjin për Gjuhët. Kurti, në një konferencë për medie me homologun e tij maqedonas, më 18 nëntor, në Prishtinë, tha se “në Maqedoni të Veriut nuk ka Ligj për Përdorim të Gjuhës Shqipe dhe nuk ka pasur as në të kaluarën. Ekziston Ligji për Përdorim të

Gjuhëve”. Kryeministri i Kosovës tha se pret vendim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut, që nuk bën përjashtime dhe respekton shumëgjuhësinë. Profesoresha Arifi e sheh deklaratën e Kurtit si të papërmbytur dhe në kundërshtim me faktet. Ajo bën thirrje që të mos relativizohen arritjet e së kaluarës, sepse “këto të drejta nuk janë fituar brenda natës”. “Këto janë çështje juridike shumë të qarta dhe ato shkruhen në Kushtetutë dhe në ligje. Një lexim pak më i thjeshtë i vendimeve të Gjykatës tregon një degradim të dukshëm që po ndodh në muajt e fundit lidhur me këto të drejta të shqiptarëve”. Shqetësimet në rritje i ka adresuar zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti, nga koalicioni shqiptar VLEN, i cili ka thënë se gjuha shqipe nuk cenohet nga qeveria dhe se të drejtat e qytetarëve nuk do të degradohen, por do të avancohen. Ndonëse është dërguar në Kushtetuese, Ligji për Gjuhët është zbatuar në pjesën më të madhe. Në institucionet qendrore, të gjitha tabelat janë në dy gjuhë, ndërsa dokumentet publikohen në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe.

Hamza për Thaçin dhe Veselin: Mungesa e tyre ka qenë një goditje e madhe për PDK-në

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Bedri Hamza, ka thënë se mungesa e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit ka qenë goditje e madhe për PDK-në. Duke folur për mungesën e tyre, Hamza ka thënë se, përveç aspektit politik e partiak, ka qenë edhe aspekti njerëzor e ai emocional. "Mungesa e z. Thaçi

dhe z. Veseli ka qenë një goditje për Partinë Demokratike të Kosovës dhe për një periudhë të shkurtër kohore, ne jemi detyruar të shkojmë në zgjedhje dhe normalisht që, përveç këtij aspekti politik, partiak, institucional, ka qenë edhe aspekti njerëzor, emocional, për shkak se kemi edhe lidhje emocionale, miqësore, shoqërore dhe ka qenë një goditje shumë e

madhe për Partinë Demokratike të Kosovës", ka thënë Hamza në "Rubikon" të "Klan Kosovës". Më tutje, ai ka folur për programin qeverisës të tij, duke premtuar rritjen e pagave dhe pensioneve për 50 për qind, investime në infrastrukturë etj. Hamza është shprehur besimplot se do të dalin fitues në zgjedhjet e 9 shkurtit të vitit 2025.



Shqipëria: Pasivizimi i adresave të shqiptarëve në Luginë, shkelje e të drejtave të njeriut



TIRANË, 22 NËNTOR - Ministria për Evropë dhe Punë të Jashtme e Shqipërisë ka thënë se është duke ndjekur me vëmendje fenomenin e pasivizimit të adresave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës, veçanërisht në Medvegjë. Përmes një reagimi publik, kjo ministri ka thënë se ky veprim përbën një shkelje të të drejtave të njeriut dhe të standardeve për mbrojtjen e pakicave, duke privuar, sipas tyre, shqiptarët nga qasja në shërbime bazë dhe ushtrimi i të drejtave të tyre themelore. "Pasivizimi i adresave nuk

është një çështje thjesht ligjore, por ka pasoja mbi jetën e përditshme të shqiptarëve në këtë rajon, duke cenuar të drejtat dhe barazinë e tyre", është thënë në reagimin e Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme e Shqipërisë. Ministria ka thënë se ka adresuar dhe do të vazhdojë të adresojë këtë çështje në dialogun me autoritetet serbe, si dhe në forume ndërkombëtare. "Përmes angazhimit të saj të vazhdueshëm, Shqipëria do të vazhdojë ta kërkojë mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në

Luginën e Preshevës në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe pakicave", është thënë në këtë reagim. Mijëra shqiptarë etnikë nga tri komuna në Serbinë jugore, Medvegjë, Bujanoc dhe Preshevë, u janë shënjuar adresat si "joaktive" prej autoriteteve të atjeshme serbe. Kjo nënkupton se ata nuk mund t'i përtërijnë dokumentet e tyre të identifikimit, ose t'i ushtrorin të drejtat e tyre që kërkojnë letërnjoftimet, si votimi. Çështja ka shkakuar një mori protestash në rrugë në rajon.

Kurti: Synim i Serbisë mbetet hakmarrja, Kosova duhet të jetë e përgatitur

Prishtinë, 22 nëntor - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se elita politike në Beograd nuk ka hequr dorë nga projekti i Serbisë së Madhe. Kurti ka thënë se Vuçiqi thjesht po e mashtron Perëndimin. "Aspak, Vuçiqi thjesht po e mashtron Perëndimin. Elita që dominon vendin nuk ka hequr dorë kurrë nga projekti i Serbisë së Madhe. Thjesht quhet diçka ndryshe tani, domethënë 'Bota Serbe'. Kjo do të thotë bashkim i të gjithë serbëve në një vend. Kjo do të nënkuptonte shpërbërjen e

Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Kosovës", ka thënë Kurti për gazetën zvicerane "NNZ". Kurti ka thënë se qëllimi i Serbisë është hakmarrja, dhe Kosova duhet të jetë e përgatitur. Thjesht duhet të dëgjoni me kujdes se çfarë po thotë Vuçiqi, ka vazhduar Kurti. "Për shembull, kur bëhet fjalë për Kaukazin e Jugut. Në vitin 2023 presidenti serb vlerësoi veprimet e Azerbajxhanit për 'kthimin në shtëpi' të Nagorno-Karabakut. Zona shpallë në mënyrë të njëanshme pavarësinë më

1991. Presidenti i Azerbajxhanit, Ilham Aliyev, më pas mori kohën e tij. Ai u përqendrua në zhvillimin e ekonomisë dhe riarmatosi sistematikisht ushtrinë. Vetëm kur situata gjeopolitike e lejoi, ai goditi dhe rifitoi zonën. Durimi, sipas Vuçiqit, shpërblehet. Kjo është pikërisht ajo që Vuçiqi dëshiron të bëjë me Kosovën. Ushtron durim strategjik, por synimi mbetet hakmarrja. Ne duhet të jemi të përgatitur për këtë", ka deklaruar kryeministri Kurti.



Konjufca bisedon me delegacionin e Azisë Jugore për njohjen e Kosovës nga vendet mosnjohëse

Prishtinë, 22 nëntor - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premtën në takim delegacionin nga Azia Jugore, i përbërë nga profesorë, studiues, anëtarë institutësh dhe gazetarë që vijnë nga vende si Nepali, Bangladeshi, India dhe Maldivet. Pasi i ka falënderuar për vizitën, kryetari Konjufca është shprehur rreth kompozimit gjeopolitik evropian, ku bën pjesë edhe



Republika e Kosovës, si dhe nevojën për një bashkëpunim sa më

progresiv dhe vleror mes vendeve të kontinentit të Evropës dhe Azisë.

Po ashtu, kryekuvendari Konjufca dhe mysafirët kanë diskutuar rreth çështjeve të ndryshme ku përfshihet nevoja për rritje të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe vendeve të Azisë Jugore në fusha të tregtisë, por edhe të parlamentarizmit, nevojën për njohjen e Republikës së Kosovës nga vendet mosnjohëse të këtij rajoni, për rëndësinë e parlamentarizmit dhe rolin e mediave.

Mysafirët të cilët gjenden në Prishtinë për të marrë pjesë në Konferencën "Prishtina Dialogue", e kanë falënderuar kryetarin Konjufca për pritjen dhe diskutimin përmes të cilit janë njoftuar së afërmi me pikëpamjet, kontekstin e vendit dhe rajonit tonë, përbrenda një bote ku sfida e distancës gjeografike duhet të humbë rëndësi përballë nevojës së bashkëpunimit në nivel të shteteve, organizatave dhe qytetarëve.

Barnatorja Qendrore e mbushur me barna pa afat, MSh-ja thotë se po angazhohet për asgjësim

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Në pamundësi të asgjësimit, një numër i konsiderueshëm i barnave dhe materialeve mjekësore me afat të skaduar janë grumbulluar në Barnatoren Qendrore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Por që nga viti 2010 në Kosovë nuk ka ndodhur asgjësimi i barnave pa afat. Ndër medikamentet me afat të skaduar është edhe Remdesivir, bari të cilin qytetarët në kohën e pandemisë Covid-19 e blenë me çmime shumë të larta. Drejtoresha e Barnatores Qendrore pranë QKUK-së, Dardane Mehaj, për "Kosovapress" ka thënë se barnat dhe produktet pa afat ruhen në kushte të veçanta të ndara prej barnave të tjera. "Është një numër i konsiderueshëm. Barnat janë të natyrave të ndryshme ose të përdorimit të ndryshëm.

Nuk janë vetëm antibiotikët ose të tjera. Vlen të theksohet se produkti Remdesivir ka skaduar me sasi të madhe dhe e kemi në Barnatore Qendrore", ka thënë ajo. Për drejtoreshën e Barnatores Qendrore shkaktarë për numër të madh të barnave me afat të skaduar po shihet keqplanifikimi i bërë nga klinikat dhe spitalet. Ajo ka theksuar nevojën për asgjësimin sa më të shpejtë të ilaçeve me afat të skaduar me qëllim të liritimit të hapësirave të zëna. "Ndoshta me e quajtur keqplanifikim, se planifikimet e produkteve medicinale të barnave dhe materialeve vijnë prej klinikave... Kur ka qenë pandemia janë shpenzuar shumë produkte të tjera, mirëpo kanë mbetur pa u shpenzuar produktet", ka thënë Mehaj. Sa i përket procesit të asgjësimit të këtyre barnave në



Ministrinë e Shëndetësisë, ka thënë se janë afër zgjidhjes së këtij problemi. Zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha, ka thënë se Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me GIZ-in gjerman po përcaktojnë një hapësirë për shkatërrimin e ilaçeve pa afat. "Jemi përafërsisht afër finishit

të zgjedhjes së këtij problemi në mënyrë që mos të ketë shumë vende ku djegien apo asgjësohen këto barna, por të ketë në një vend që kostoja financiare të jetë më e vogël për shtetin", ka thënë Berisha. Në anën tjetër, derisa në sistemin shëndetësor publik po skadojnë ilaçe dhe materiale mjekësore,

qytetarët e Kosovës po vazhdojnë të blejnë barna me çmime të larta. E nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve bëjnë thirrje për hetim nga Prokuroria e shtetit për menaxhimin e barnave. Besim Kodra nga kjo shoqatë e sheh shqetësues faktin e skadencës së barnave, derisa qytetarët po blejnë barna me çmime marramendëse në sektorin privat. "Problemike për mua është qysh njerëzit me qenë pa barna dhe me pas skadim të barnave. Këtu duhet të involvohet Prokuroria", ka thënë ai. Ligji që parashihte rregullimin e çmimit të barnave për blerjet publike dhe tregun privat është miratuar në korrik të vitit të kaluar, por në mungesë të listës për çmimin e produkteve medicinale ende nuk ka nisur zbatueshmëria e tij.

Gjykata Supreme lanson udhëzuesin për matjen e dënimit

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Gjykata Supreme e Kosovës ka lansuar udhëzuesin për matjen e dënimit. Në lansimin e këtij udhëzuesi ka marrë pjesë edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier. Kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, ka thënë se Ambasada e ShBA-së në Kosovë ka luajtur rol të rëndësishëm në fuqizimin e drejtësisë dhe shtetit të së drejtës. "Kontributi i Ambasadës së Amerikës, Departamenti i Drejtësisë në vazhdimësi ka mbështetur sundimin e ligjit në vendin tonë. Me lansimin e këtij udhëzuesi, Supremja shënon një moment të rëndësishëm. Udhëzuesi i përgjithshëm i miratuar në vitin 2018 ka nxitur nevojën për rishikimin e tij - për harmonizimin e praktikave me qëllim që udhëzuesi të bëhet lehtësisht i zbatueshëm. Ky udhëzues



përfaqëson një aset të vlefshëm. Ftoj kryetarët e gjykatave që të zbatohet ky udhëzues", ka thënë Rexhepi. Ndërsa Albert Zogaj, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), ka përgëzuar Gjykatën Supreme për lansimin e udhëzuesit. "Udhëzuesi për matjen e dënimit ka historinë e zhvillimit. Ajo që në fakt u

përballë me sfidat që eventalisht mund ta zhvendoste konceptin, raportet ndërkombëtare dhe raportin e Komisionit Evropian si dhe rolin kyç që ka Gjykata Evropiane. KGJK-ja e mbështet nevojën e aplikimit të ligjeve për të siguruar balancën. Udhëzuesin e kemi vendosur në qendër të planit

të punës që ky koncept të shndërrohet në standard brenda gjyqësorit. Në drejtësinë penale ky udhëzues e konfirmon që po aplikojmë politikë ndëshkimore adekuate, çështjen e paraburgimit etj.", ka thënë Zogaj. Në anën tjetër, Besim Kelmendi, ushtrues detyre i kryeprokurorit të shtetit, ka thënë se ky udhëzues është një nga hapat më të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë. "Për udhëzuesin e parë ishim skeptikë. Edhe kryeprokurori ka lëshuar një udhëzim për matjen e dënimit. Ambasada e Amerikës ka ndihmuar për një udhëzues të tillë. Kemi shumë punë për të bërë sepse jemi në fazat e para të udhëzuesit të tillë, por jemi të lumtur që i kemi marrë praktikat e ShBA-së. Këtë udhëzues prokurorët ta vlerësojnë si të drejtë të

balancuar, në përputhje me parimet e drejtësisë. Nuk është detyrë e thjeshtë", ka thënë Kelmendi. Kurse ambasadori i ShBA-së, Jeffrey Hovenier, ka thënë se zyrtarët gjyqësorë të Kosovës po vazhdojnë të jenë shembull për shtetet e rajonit duke integruar udhëzimet në kornizën e drejtësisë penale. "Miratimi i këtyre udhëzimeve është vetëm një hap fillestar. Puna e vërtetë fillon me vënien në fuqi të këtyre udhëzimeve. Raportet ndërkombëtare dhe vendore tregojnë se sistemi gjyqësor i Kosovës ende shpesh shqipton dënime joproporcionale, duke nënvizuar nevojën për këto udhëzime", ka thënë Hovenieri. Ai ka thënë se ShBA-ja përdor udhëzues të ngjashëm prej shumë vitesh e, megjithatë, mëson çdo ditë se si t'i rregullojë këta udhëzues.

Punëtoret teknike në Kuvend refuzojnë takimin me anëtarët e Komisionit për të Drejtat e Njeriut

Prishtinë, 22 nëntor - Gratë greviste, punëtoret teknike në Kuvendin e Kosovës, kanë refuzuar të marrin pjesë në takimin me anëtarët e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut. Sipas tyre, deputetët s'kanë bërë asgjë dhe i kanë anashkaluar kërkesat e grave greviste, andaj takimi tani është i padobishëm. Në emër të grave greviste ka folur kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të

Sektorit Privat, Jusuf Azemi, i cili ka thënë se zëvendësimi i tyre në Kuvendin e Kosovës është çështje ligjore dhe po presin raportin e Inspektoratit të Punës. Për të diskutuar me gratë greviste ka dalë kryetarja e komisionit, deputetja Duda Balje, e cila ka kërkuar nga punëtoret teknike të Kuvendit të mbajnë takim, mirëpo edhe ajo është refuzuar. Pas refuzimit, deputetja



Balje ka vazhduar Ajo ka thënë se pas takimit mbledhjen e komisionit. me gratë greviste kanë

menduar ta thërrasin sekretarin e Kuvendit dhe përgjegjësit e kompanisë së pastrimit në Kuvend. Ndërsa anëtarja e komisionit, deputetja e LV-së, Fatmire Kollçaku, ka thënë se shkëputja e njëanshme e kontratës nuk i kontribuon këtij rasti. Në anën tjetër, deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka thënë se janë shkelur të drejtat e njeriut me rastin e punëtoreshave teknike të Kuvendit të Kosovës.

Haradinaj: Kosova ka nevojë për një mendësi të re qeverisëse, të bashkohemi për Kosovën fituese

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj raportimeve në medie ku është thënë se Prokuroria Speciale është duke i hetuar rreth 1700 kontrata njëburimore. Ai ka bërë me dije se Kosova ka nevojë për një mendësi të re qeverisëse. Haradinaj ka shkruar në "Facebook" se Kosova nuk ka nevojë për një mendësi ku vidhet paraja publike dhe ku jepen njoftime për mijëra kontrata njëburimore nën hetim. "Kosova ka nevojë për një mendësi të re qeverisëse, ku

nuk vidhet paraja e qytetarëve e ku jepen njoftime se po hetohen 1700 kontrata njëburimore. Ka nevojë për një model të ri, ku nuk preket ndarja e pushteteve, ku nuk sulmohet gjyqësori, ku nuk sulmohen mediat e shantazhohen gazetarët, por ku liria e fjalës e demokracia institucionale janë të paprekshme. Ku qytetari nuk vuan për bukën e gojës e nuk kërkon shpëtim duke e braktisur vendin e vet", ka shkruar Haradinaj. Ai ka vlerësuar se për këto katër vjet Kosova ka shënuar vetëm humbje. "Më në fund

Kosova ka nevojë ta rikthejë miqësinë e mbështetjen e partnerëve strategjikë, pa të cilët nuk do të arrinim asgjë. Ne duhet ta arrijmë cakun tonë që është anëtarësimi direkt në NATO, i cili do të kthente gjithçka kah e mbara. Kosova për këto katër vjet, ka shënuar vetëm humbje, edhe në planin e brendshëm, edhe në zhvillim, edhe në mirëqenie, por edhe në planin ndërkombëtar. Kosova sot është më e dobët se asnjëherë më parë në këto 25 vjet liri. Prandaj ne duhet të bashkohemi për Kosovën fituese!", ka shkruar Haradinaj.



"Shpata e Artë", trajnohen KFOR-i, EULEX-i dhe Policia e Kosovës

Prishtinë, 22 nëntor - Misioni i KFOR-it i udhëhequr nga NATO-ja, ai i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX-i) dhe Policia e Kosovës do ta zhvillojnë stërvitjen e përbashkët, "Shpata e Artë 2024", në Kampin Vrelo (Prishtinë) deri më 25 nëntor

2024. Stërvitja do ta testojë zbatimin e procedurave të menaxhimit të krizave, në skenarë të ndryshëm sigurie. Ky trajnim, sipas KFOR-it, do të përfshijë rreth 600 personel dhe asete në të gjithë zonën e stërvitjes në Prishtinë, si dhe në rrethinën e saj dhe përgjatë rrugëve kryesore.

Banorët vendas mund të presin kështu një rritje të përkohshme të trafikut rrugor. "Shpata e Artë 2024" është një tjetër dëshmi e KFOR-it, EULEX-it dhe Policisë së Kosovës që punojnë së bashku, në mbështetje të sigurisë së qëndrueshme në mbarë Kosovën dhe stabilitetit rajonal", ka njoftuar KFOR-i.

FSK-ja teston kapacitetet në fushën e komunikimit

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Forca e Sigurisë së Kosovës ka testuar kapacitetet e ndërlidhjes në ushtrimin fushor të komunikimit "Sinjali 2", në kuadër të ngritjes së kapaciteteve operacionale në këtë fushë. Sipas FSK-së, qëllimi i këtij ushtrimi është testimi i kapaciteteve të komunikimit të të gjitha njësive në nivel operacional dhe taktik për

ofrimin e komandim-kontrollit në mbështetje të operacioneve luftarake, mbështetjes me shërbime përmes rrjeteve dhe sistemeve të teknologjisë informative. "Përveç ngritjes, modernizimit dhe ofrimit të shërbimeve të C4I, është testuar edhe qëndrueshmëria e rrjeteve /sistemeve dhe monitorimi nga Qendrat Komanduese", ka njoftuar FSK-ja.



Ushtarët e Kosovës dhe të Shqipërisë ushtrojnë bashkë, synim i FSK-së, integrimi në NATO



Prishtinë, 22 nëntor - Në kuadër bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Regjimenti i Mjekësisë së FSK-së ka marrë pjesë në ushtrimin e përbashkët me Shërbimin Mjekësor të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh) ku kanë realizuar stërvitjen e përbashkët për ROLI. Sipas njoftimit të FSK-së,

qëllimi i këtij aktiviteti ishte avancimi i ndërveprueshmërisë profesionale mjekësore ndërmjet të dy forcave, ku synim i përbashkët është integrimi në strukturat e NATO-s. "Ky është një hap shtesë në përafrimin dhe standardizimin e procedurave për këtë funksion të rëndësishëm të mbështetjes luftarake. Gjithashtu ky aktivitet kishte një rendësi të madhe edhe për përgatitjen e dy njësive për

procesin MEDEVAL të NATO-s. Forca e Sigurisë së Kosovës falënderon Forcat Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe ofrimin e kapaciteteve të saj në zhvillim të aktiviteteve bilaterale. FSK-ja dhe FARSh-i vazhdimisht zhvillojnë aktivitete bilaterale në përmbushje të objektivave përkatëse duke kontribuar në paqen dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë", ka njoftuar FSK-ja.

Nënshkruhet kontrata për zgjerimin e rrugës në hyrje të Ferizajt

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije se të premtën ka nënshkruar kontratën për realizimin e projektit "Zgjerimi i rrugës në hyrje të Ferizajt", një projekt ky i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) që kap vlerën e 16.4 milionë eurove.

Aliu ka treguar se punimet pritet të zgjasin një vit sipas planit dinamik. "Pas një periudhe sfidash dhe ndërprerje të kontratës me kontraktorin e mëparshëm që u trashëgua nga 2019 nga qeveria e kaluar dhe që u tregua i papërgjegjshëm, këtë vit rifilluam procedurat e prokurimit dhe sot kemi nënshkruar kontratën me operatorin e

ri për përfundimin e këtij projekti. Ky projekt do të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën e rrugës Nacionale N2, duke e zgjeruar atë në një rrugë me nga dy korsi në secilin drejtim, dhe do të kontribuoj në rritjen e sigurisë dhe lehtësisë së qarkullimit për qytetarët e Ferizajt dhe të gjithë rajonit", ka thënë Aliu.



Hekurudha Durrës - Prishtinë, Aliu: Kosova financon pjesën e vet, por nuk është lidere e projektit



PRISHTINË, 22 NËNTOR - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se hekurudha që lidh Prishtinën me Durrësin është 130 kilometra. Aliu në një konferencë për medie ka treguar se 30 prej këtyre kilometrave janë në pjesën e Kosovës dhe kryesisht në terren të rrafshët, ndërsa 100 kilometrat e tjera ai ka thënë se

janë në territorin e Shqipërisë. Aliu ka theksuar se kur është bërë marrëveshja në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, Kosova është palë që financon pjesën e vet, por jo të jetë lidere e projektit. "Hekurudha Durrës - Prishtinë. Duhet ta kemi parasysh se duhet të ndërtohet një hekurudhë e re, e jo rindërtimi i hekurudhës së vjetër. Hekurudha e re është 130

kilometra. Nga këto kilometra, 100 prej tyre janë në Republikën e Shqipërisë. Këto 100 kilometra atje janë në territor malor, me shumë tunele e ura, ndërsa në pjesën tonë janë në terren të rrafshët. Prandaj kur e kemi bërë marrëveshjen me Shqipërinë, ne jemi si palë e cila financon pjesën e vet, por nuk mundet me qenë lidere e projektit", ka thënë Aliu.

Hamza: Ne jemi adresa e zhvillimit të bujqësisë dhe ekonomisë së Kosovës

RAHOVEC, 22 NËNTOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Bedri Hamza, ka mbajtur një tubim me qytetarët e Rahovecit. Hamza ka thënë se vreshtarët,

verëtarët dhe të gjithë qytetarët e Rahovecit e dinë kënd e kishin krah pune e kush u ka ndihmuar sa herë që kanë pasur nevojë. Ai ka theksuar se PDK-ja është adresa e zhvillimit të bujqësisë

në të gjithë Kosovën. "Entuziazëm gjithandej nëpër Kosovë. Besim kudo në mesin e qytetarëve. Këto i pashë edhe në Rahovec, në mesin e këtyre punëtorëve të mëdhenj e patriotëve të dëshmuar.

Rahoveci po i bashkohet përpjekjeve tona për ta bërë Kosovën më të mirë. Vreshtarët, verëtarët dhe gjithë qytetarët e Rahovecit, e dinë kënd e kishin krah pune e kush iu ka ndihmuar sa herë që kanë

pasur nevojë. Ata e dinë që ne jemi adresa e zgjidhjes së problemeve të tyre. Ne jemi adresa e zhvillimit të bujqësisë, ekonomisë dhe zhvillimit të Kosovës", ka shkruar Hamza në "Facebook".



Kosova konsumoi më pak energji në shtator të këtij viti se në muajin e njëjtë të vitit paraprak

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka bërë me dije se gjatë muajit shtator të vitit 2024 energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 450.55 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike

ishte 343.61 GWh ose (- 4.55 për qind) më i vogël krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. ASK-ja ka theksuar se pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në

kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 9.79 për qind. "Importi i energjisë elektrike në shtator 2024 ishte 166.73 GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në këtë periudhë ishte 114.34 GWh

(këtu është e përfshirë edhe sasia e transmisionit). Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 599.92 mijë ton, ose (-0.42 për qind) më pak sesa në muajin e njëjtë të vitit paraprak", ka njoftuar ASK-ja.



KONGRESI I MANASTIRIT - KONGRESI I ABC-së

Sipas dokumenteve arkivore të Austro-Hungarisë



Shkruan:
Prof. dr. Eqrem ZENELAJ

I. Kongresi i Manastirit ishte Kongresi i unifikimit të një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe.

Ai ka tubuar dijetarët dhe atdhetarët shqiptarë nga data 14 nëntor deri më 22 nëntor të vitit 1908 në qytetin e Manastirit.

Në kongres ishin të pranishëm 160 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë, etj.

Kryetar i Kongresit u zgjodh Mit'hat Frashëri, ndërsa kryetar i Komisionit Atë Gjergj Fishta. Sekretare e komisionit u zgjodh Parashqevi Qiriazi, mësuese e shkollës së vashave në Korçë.

Nënkryetar i Kongresit u zgjodh Grigor Cilka nga Korça, si dhe 11 anëtarë të tjerë.

Në atë kongres merrnin pjesë shqiptarë të katër religjioneve: myslimanë, katolikë, ortodoksë dhe protestantë.

Përgatitja dhe mbajtja e Kongresit të Manastirit më 1908 ishte subvencionuar për disa vite nga Austro-Hungaria, sidomos përmes klerikëve fetarë, për të qenë unikë dhe të bashkuar për një alfabet të përbashkët shqiptar nga ana e Konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë në Shkodër, August von Kral.

Ja si shkruhet në dokumentet arkivore të Vjenës për Kongresin e Alfabetit të Manastirit më 1908:

II. Rivaliteti dhe konkurrenca për Shqipërinë dhe Adriatikon ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë ishte në rritje që nga koha e Oto von Bismarkut dhe kryeministrit të Italisë, Françesko Krispi (arbëresh). Austria kishte një kultprotektorat mbi Shqipërinë që nga viti 1699, përmes të cilit shqiptarët kishin të drejtë të ushtronin fenë e tyre, të ndërtonin e meremetonin kulte fetare, si dhe përmes propagandës së Romës financoheshin kleri katolik, shtypi dhe botimet fetare në gjuhën shqipe.

Me bashkimin e Italisë dhe forcimin e saj, investimi i Austrisë për një kohë të gjatë te kleri filloi t'i kthehej si bumerang, sepse kleri katolik, i cili për një kohë të gjatë subvencionohej nga Austria, një pjesë e tij tani mbështeste politikën dhe interesat e Italisë. Ndër klerikët kryesorë



).HHStA-Wien.P.A.-Nachlässe von Augustin Kral-Karton nr.3.Hil Mosi (Këtë foto të vetën- Hilë Mosi ia kishte dhuruar-Konsullit të Austro-Hungarisë August Kralit).

dhe paria kryesore që një kohë ishin kthyer kah Italia ishte monsinjor Prenkë Doçi, ndërsa nga paria shqiptare e Shqipërisë veriore ishte prijësi i Mirditës, Prenkë Pasha.

Po sipas burimeve arkivore dhe dokumenteve të shumta, bëhet me dije se edhe Alfabeti i Bashkimit subvencionohej dhe ishte nën ndikimin e propagandës dhe interesave të

Italisë. Përpjekjet e Austro-Hungarisë për t'i përvetësuar klerin dhe parinë shqiptare, të cilët punonin dhe subvencionoheshin nga Italia,




ajo, nëpërmjet konsullit të përgjithshëm të Austro-Hungarisë dhe përfaqësuesit të Ministrisë së Jashtme për kultprotektoratin në Shkodër, August von Kral, arriti që krerët shqiptarë t'i bashkojë dhe t'i bindë të takohen në një kongres të përbashkët, duke i lënë interesat vetjake mënjanë, për ta formuar një alfabet unik të gjuhës.




Në një njoftim të datës 30 qershor të vitit 1905, i cili vjen nga Shkodra (Konsullata e Përgjithshme) për Vjenën, ndër të tjera, shkruhet:

"Para një muaji është bërë e njohur që italianët shkojnë në atë që gjuha shqipe të jetë e obliguar për objektet shkollore italiane në të cilat vijnë shqiptarët. Madje, konsullata italiane i ka shpërndarë disa ekzemplarë të shtypura nga një shoqatë shqiptare në Itali."

Pas shumë përpjekjeve, unë ia arrita (shkruan August von Kral, nënvizimi im, E. Z.) ta siguroj një 'Abetare' të tillë të shtypur në Itali. Po ashtu, në shkolla shqipe kërkohet të futet Alfabeti i Shoqërisë Bashkimi.

"Austro-Hungarisë në Shkodër, August von Kral, në





një njoftim tjetër për Vjenën shkruan:”

Përpjekjet shumëvjeçare janë kurorëzuar me një rezultat konkret, pasi tanimë është gjetur një kompromis mes shqiptarëve. Ata tashmë janë bërë unikë, në krye me përfaqësuesit e tri alfabetëve shqiptarë:

Alfabeti Toskë,

Alfabeti i Mjedës,


dhe Alfabeti i Jezuitëve (që i referohet Alfabetit të Shoqërisë Bashkimi të Shkodrës, përfaqësuar dhe përdorur nga Atë Gjergj Fishta).

Në fakt, atdhetarët e shumë shqiptarë ishin ata që kërkonin përparimin e gjuhës

amtare, aq sa thurnin vjersha për të dhe krenoheshin me të. Njëri ndër këta atdhetarë ishte Hilë Mosi, i cili kishte kontakte miqësore me Austrinë, sidomos me përfaqësuesin e saj në Shkodër, konsullin gjeneral August von Kral. Ky i fundit, mik i madh i shqiptarëve, bëri shumë për ta dhe për Shqipërinë.

Në një shkresë konfidenciale, August von Kral i bën me dije Vjenës se edhe Prenkë Doçi është izoluar dhe, për rrjedhojë, tani ka pranuar të pranojë një alfabet që do të vendosej nga një pajtim i mazhorancës shqiptare.

Shih më poshtë faturat e



subvencionimeve për Atë Gjergj Fishtën nga Austro-Hungaria.

August von Kral, në raportet e tij mbi Kongresin e Manastirit, i shkruan Vjenës si më poshtë: “Drei der albanesischen Alphabetparteien, nämlich die toskische, die media’sche und die der Jesuiten haben sich unter meiner jahrelangen Einwirkung geeinigt, die Alphabetfrage durch ein Kompromis-Alphabet zu lösen. Der Einwirkung dieser bedeutungsvollen Tatsache konnte sich auch der isoliert gebliebene Msgr. Primo Doçi nicht entziehen und erklärt nun auch seinerseits, das Alphabet der Majorität zu akzeptieren. Ein in wenigen Wochen in Monastir zusammengetretener Albanesen-Kongress, zu welchem Delegierte aller Parteien erscheinen werden, wird das zukünftige Alphabet festsetzen und namens der Nation proklamieren.”

Përkthim dhe përshtatje:

Të tria palët e alfabetëve shqiptarë – Alfabeti Toskë, Alfabeti i Mjedës dhe ai i Jezuitëve – gjatë një përpjekjeje dhe zhvillimi shumëvjeçar, tanimë janë pajtuar që çështjen e alfabetit ta zgjidhin me anë të një kompromisi. Zhvillimi i kësaj çështjeje me rëndësi nuk ishte i mundur pa tejkalimin e qëndrimit të izoluar të monsinjor Prenkë Doçit. Në anën tjetër, theksohet se alfabeti nuk mund të pranohet nga mazhoranca pa një kompromis.

Në javët e ardhshme, delegatë të të gjitha palëve do të takohen në një kongres shqiptarësh në Monastir. Në këtë takim, alfabeti i njësuar do të shpallet dhe do të proklamohet në emër të kombit shqiptar.

(Burimi: Telegrami Nr. 9249, Herr Kral, Scutari, 7 shtator 1908. HHStA, PA. XIV, Albanien, Liasse XIV, XV, XVII/1-4, Chiffre Nr. 42)

Sistemi raketor rus i panjohur për Perëndimin dhe i padukshëm për mbrojtjen ajrore të Ukrainës! Çfarë janë raketat Oreshnik që goditën dje Kievin?

Konflikti në Ukrainë po merr një dimension të ri pas përdorimit nga Rusia të një sistemi raketor të panjohur Oreshnik, i cili po shkakton shqetësim në Perëndim. Sulmi në Dnipro u shoqërua me një fjalim të presidentit rus Vladimir Putin, duke ngritur edhe më shumë shqetësim serioze për ecurinë e luftës.

Testi i raketës specifike, siç e përshkroi ai, dhe shpejtësia me të cilën po përshkallëzohet tensioni në rajon, përforcojnë frikën e përshkallëzimit të mëtejshëm me pasoja globale. Injoranca e Perëndimit për karakteristikat e kësaj arme hipersonike dhe retorika

kërcënuese e Putinit shtojnë ndjenjën e pasigurisë dhe presionit diplomatik, shkruajnë mediat e huaja. Me pak çfarë dihet për arsenalin e Rusisë, raketat Oreshnik janë një nga sistemet raketore më të avancuara që Moskë ka zhvilluar gjatë pesë viteve të fundit. Këto raketa i përkasin gjeneratës së re të raketave me rreze të gjatë veprimi, por jo të rrezes ndërkontinentale, siç u njoftua zyrtarisht nga Kievi pak orë më parë.

Deklarata e presidentit ukrainas, Volodymyr Zelenskyy, solli edhe reagime perëndimore nga analistë (kryesisht) të cilët theksuan se

raketa me koka të shumta që goditi Dnipro herët dje nuk i përket kësaj kategorie sistemesh.

Oreshnikët janë gjithsesi një nga armët, karakteristikat dhe dinamika e të cilëve aktualisht i mungojnë Perëndimit. Sipas asaj që deklaroi presidenti rus, Vladimir Putin, dhe raportohet nga mediat ruse, përparësia kryesore e këtyre raketave është shpejtësia me të cilën ato godasin objektivat e tyre gjatë zbritjes.

Më konkretisht, Oreshnikët zhvillojnë një shpejtësi prej 2 deri në 3 kilometra në sekondë, gjë që praktikisht i bën ata të jenë përtej

supersonikës dhe "të padukshëm" për sistemet e mbrojtjes ajrore, të cilat Kievi i ka zhvilluar aktualisht kryesisht rreth qendrave të tij të mëdha urbane dhe njërive kryesore të energjisë.

Oreshnikët i përkasin "familjes" së armëve hipersonike pasi godasin në fakt me shpejtësi që kalon 10800 km/h dhe bëjnë pjesë në kategorinë që përfshin raketat që lëvizin me shpejtësi nga 6100 km/h deri në 12300 km/h. Këto raketa janë gjithashtu të afta për koka luftarake të shumta dhe nuk janë ndërkontinentale, por me rreze të gjatë, pasi ata

udhëtojnë një distancë prej jo më shumë se 900 kilometra. Ajo që është gjithashtu e sigurt bazuar në fjalët e Putinit është se goditja në Dnipro është e para që Rusia ka tentuar me këtë sistem të veçantë të armëve.

Në fakt, Vladimir Putin e quajti atë një "test", që është më shqetësuesja nga zhvillimet e 5 ditëve të fundit. Nëse Rusia ka marrë vendimin për t'iu përgjigjur sulmeve balistike perëndimore në territorin e saj edhe duke përdorur armë nën provë, atëherë përshkallëzimi ka të ngjarë të ketë dimensione që Perëndimi dhe Kievi sot nuk duket se i kanë llogaritur.



Britania dhe Franca: Nuk do të lejojmë Putinin të ndryshojë rendin botëror

Mbretëria e Bashkuar dhe Franca do të bëjnë "çdo gjë që është e nevojshme" për të vazhduar mbështetjen e Ukrainës dhe për ta vënë Kievin "në pozicionin më të mirë për të arritur një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme". Kështu lexojmë në një letër të përbashkët të ministrit të Jashtëm britanik, David Lammy dhe homologut të tij francez Jean-Noel Barrot, të publikuar nga Guardian. "Duke nisur luftën e tij 1000-ditore të agresionit në shkallë të gjerë të paligjshme dhe të paprovokuar në Ukrainë, Vladimir Putin jo vetëm që shkaktoi luftën më të madhe në kontinentin evropian që nga Lufta e Dytë Botërore, por gjithashtu u përpoq të rishkruante rendin ndërkombëtar," shkruajnë ata të dy. . Asgjësimi i arkitekturës globale që ka qenë gurthemeli i paqes dhe sigurisë ndërkombëtare për të justifikuar agresionin e saj të



paligjshëm kundër një vendi sovran evropian, së bashku me aleatët tanë do të bëjë gjithçka që është e nevojshme për ta vendosur Ukrainën në pozicionin më të mirë për të arritur një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme", përfundon

letra nga Londra dhe Parisi.

Këshilli i NATO-s mblidhet pas lëshimit të raketës së re ruse


Pas vendosjes së një rakete të

re ruse me rreze të mesme veprimi, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mark Rutte thirri një takim të Këshillit NATO-Ukrainë. Takimi i planifikuar për të martën e ardhshme do të fokusohet në sulmin e

djeshëm rus në qytetin ukrainas Dnipro, raporton Ard. Rusia ka lëshuar raketën e re me rreze të mesme veprimi të quajtur 'Oreshnik'. Sipas informacioneve të NATO-s, konsultimet në Bruksel organizohen me kërkesë të qeverisë së Kievit dhe zhvillohen në nivel ambasadori. Komiteti u krijua për shkëmbim në situata krize në Ukrainë.

Rreziku i sulmeve ruse, Parlamenti anulon seancën

Parlamenti ukrainas ka anuluar seancën e sotme të orës së pyetjeve për shkak të rrezikut të një sulmi raketor rus. Yevgenia Kravchuk, një parlamentare nga partia në pushtet, tha për AFP. "Ka shenja të një rreziku të sulmeve në qarkun qeveritar në ditët në vijim," shtoi ai.



Kosova kundër Islandës në 'play-off' për Ligën B



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do të luajë kundër Islandës në ndeshjen e "play-off"-it për promovim në Ligën B të Ligës së Kombeve. Kjo u vendos në shortin e tërhequr të premtën në selinë e UEFA-s në Nion. Të pranishëm në ceremoninë e shortit ishin presidenti i FFK-së, Agim Ademi, përzgjedhësi Franco Foda, zëvendësudrejtori Samir Ujkani dhe menaxheri Bajram Shala. Përzgjedhësi Foda ka thënë se gjasat janë të barabarta në këtë plejof, por ka shtuar se

Kosova do të bëjë të pamundurën për t'u promovuar në Ligën B. "Nuk kishim asnjë ndikim në shortin e hedhur, por tani jemi të lumtur për ndeshjen kundër Islandës. Unë personalisht nuk kam qenë kurrë në Islandë dhe Islanda ka një skuadër të fortë. Por edhe ne, me kombëtaren tonë, jemi aktualisht në një formë shumë të mirë, në një gjendje shumë të mirë. Mendoj se shanset janë 50 me 50 dhe do të bëjmë gjithçka për të kaluar në Grupin B", ka thënë Foda.

Për ndeshjen ndaj Kosovës ka folur pas shortit edhe trajneri i Islandës, Age Hareide, i cili ka vlerësuar lart potencialin e

"dardanëve", ndërsa shortin e ka cilësuar tejet të vështirë. "Nuk ka diferencë të madhe ndërmjet shumicës së skuadrave të Ligës B dhe C. Për ne është e rëndësishme të qëndrojmë në Ligën B dhe për ta arritur këtë, duhet t'i bëjmë dy paraqitje të mira ndaj një kundërshtari të vështirë. Kemi një grup të mirë të lojtarëve dhe shpresoj se të gjithë do të jenë të gatshëm për këto ndeshje të marsit", ka thënë Hareide.

Ndeshjet e "play-off"-it zhvillohen në mars të vitit të ardhshëm. Kosova dhe Islanda janë takuar edhe më parë në ciklin kualifikues të Botërorit 2018.

'Vrapimi i Nëntorit', një mënyrë e veçantë e festimit të 28 Nëntorit

PRISHTINË, 22 NËNTOR - "Vrapimi i Nëntorit", si një nga format më autentike të shënimit të Ditës së Flamurit tonë Kombëtar, ditëlindjes së komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, ditës së daljes së parë publike të UÇK-së si dhe nderimit të të gjithë të rënëve për liri dhe pavarësi, do të mbahet edhe këtë 28 Nëntor në Prekaz. Ky është edicioni i katërt i këtij eventit, tashmë tradicional ndërsa, sipas platformës KosovoPass, regjistrimi është i hapur deri më 23 nëntor 2024, ora 00:00, për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të garojnë në këtë vrapim. Siç njofton KosovoPass, vrapimi do të bëhet në dy disiplina: 28 km, që simbolizon 28 Nëntorin dhe 11 km, që simbolizon muajin nëntor. Risi e këtij eventit është se garat 11 km dhe 28 km tani



janë pjesë e UTMB Index – organizatës më elitare të vrapimit malor. Të gjithë vrapuesit/et që përfundojnë garat, do të marrin pikë të

njohura ndërkombëtarisht. "Vrapimi i Nëntorit" fillon nga Prekazi legjendar dhe përfundon në qendër të Skenderajt.

SHKURT

KH Rahoveci synon fitore ndaj skuadrës rumune

Skuadra e Rahovecit në hendboll sonte (e shtunë) në orën 19:00 e pret ekipin rumun CS Minaur Baia Mare në ndeshjen e parë në EHF European Cup. Kjo skuadër po synon ta shkruajë historinë në sportin e Kosovës duke u bërë skuadra e parë që kualifikohet në mesin e 16 skuadrave më të mira. "Ky është një mision jashtëzakonisht i vështirë, pasi kemi të bëjmë me një ekip me përvojë të jashtëzakonshme në këto nivele. Madje mund të themi se ekipi rumun është një nga favoritët e kësaj gare. Duam të dëshmojmë se jemi të gatshëm për ndeshje të këtyre niveleve dhe do të japim gjithçka nga vetja. Por, do të jetë definitivisht e pamundur pa përkrahjen tuaj masive në Rahovec", thuhet në postimin e KH Rahoveci. CS Minaur Baia Mare është tri herë kampion në Rumani, 6 herë fitues i kupës, 2 herë fitues i EHF Cup, gjysmëfinalist i edicionit të fundit të EHF European Cup dhe finalist në vitin 2022. Ka pjesëmarrje edhe në Ligën e Kampioneve. Përkundër disa vështirësive financiare me të cilat përballet, ka ekip kompakt me lojtarë shumë të fortë.

Superliga rikthehet sot me dy ndeshje interesante

Pas ndeshjeve të Kombëtareve në Ligën e Kombeve këtë fundjavë rikthehet Superliga e Kosovës në futboll me xhiron e javës së 14-t. Sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshje, ku Malisheva do ta presë ekipin në superformë, Dukagjinin. Ndeshja tjetër është ajo në mes të Feronikelit 74 dhe Gjilanit. Ndërsa të dielën zhvillohet një ndeshje shumë interesante, ku Prishtina do të jetë nikoqire e Ballkanit në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 17:00. Suhareka në anën tjetër do t'i bëjë konak Ferizajt, ndërsa të hënën zhvillohet kryendeshja e kësaj xhiroje në mes të Dritës dhe Llapit.

Messi: Me familje mendojmë të kthehemi për të jetuar në Barcelonë

Leo Messi ka folur me shumë admirim për Barcelonën në intervistën e tij të fundit. Ylli argjentinas tashmë po bën karrierë në ShBA me Inter Miamin, por Barcelona mbetet pjesa më e bukur për të. Aty ai u formësua si lojtar dhe fitoi krejt çka mund të fitohet si me ekip, ashtu edhe individualisht. Duke folur për periudhën e tij në Kataluni, tetë herë fituesi i "Topit të Artë" foli me shumë admirim.

"Fëmijët e mi kanë lindur atje. Kam kaluar gjithë jetën time duke jetuar atje. Ndihej sikur i përkas Barcelonës. Unë dhe familja ime gjithmonë mendojmë për mundësinë që një ditë të kthehemi për të jetuar atje. Fëmijët e mi, gruaja ime dhe unë e kemi shumë mall jetën tonë atje. Na mungojnë miqtë tanë", u shpreh Messi.

Lakersat humbasin në sekondën e fundit, triumfojnë San Antonio, Charlotte dhe Toronto

LOS ANXHELOS, 22 NËNTOR - Lakersat u mundën me rezultat 119-118 në sekondën e fundit nga Orlando, duke humbur një shans të mirë për ta kapur kreun në Perëndim. Franz Wagner me 37 pikë e 11 asistime ishte lider për

miqtë, duke i bërë të pavlefshme 70 pikët e dyshes Davis - James. Fitoi edhe skuadra e Charlottes, që mundi me rezultat 123-121 Detroitin, në fund të një ndeshje të ekuilibruar. Brandon Miller me 38 pikë ishte shënuesi më i mirë për

vendasit, njeriu që i dhuroi fitoren. Ekipi i San Antonio fitoi me rezultat 126-118 ndaj Utah Jazzit, duke ngjitur disi shkallët në renditje. Tetë basketbollistë të Spursit kaluan kuotën e 10 pikëve. Nuk zhgënjeu Toronto, që në shtëpi fitoi

me rezultat 110-105 ndaj Minnesotas, sfidë ku protagonist ishte RJ Barrett me 31 pikë. Rezultatet: Charlotte-Detroit (123-121), Toronto-Minnesota (110-105), San Antonio-Utah Jazz (126-118), Lakers-Orlando (118-119).



'Perandori' do të luajë ndeshjen lamtumirëse në 'Maracana'

RIO DE JANEIRO, 22 NËNTOR - Adriano do ta luajë ndeshjen e tij të lamtumirës nga futbollit... tetë vjet pas herës së fundit që zbriti në fushë. Ish-sulmuesi i Parmës, Interit dhe Romës ka vendosur të organizojë një ngjarje më 15 dhjetor në stadiumin legjendar "Maracana" në Rio de Janeiro. Ngjarja është quajtur "Beteja e fundit e Perandorit". Në të do të marrin pjesë disa yje që kanë luajtur krah tij, si me Flamengo, ashtu edhe në futbollin italian. Nga Flamengo pritet të jenë të pranishëm legjenda si Zico, Junior, Petković, Leo Moura, Vagner Love dhe Ronaldo Angelim. Një moment që premtan të jetë emocionues për fansat dhe një mbyllje simbolike për një karrierë të shënjuar nga shkëlqimi dhe vështirësitë. Në ngjarjen e lamtumirës nga futbollit të Adrianos do të marrin pjesë edhe shumë yje që kanë shkëlqyer krah tij në futbollin italian: Ivan Ramiro Cordoba, Nicolas Burdisso, Carlos Gamarra, David Pizarro, Maxwell, Maicon dhe Julio Cesar. Ish-sulmuesi, i emocionuar, ka



deklaruar ditët e fundit: "Ajo që dikur ishte një ëndërr po bëhet realitet. Jam shumë i lumtur që kaq shumë yje dhe miq do të jenë të pranishëm në ndeshjen time të lamtumirës. Mezi po pres që të vijë ai moment. Do të jetë një festë e madhe". Adriano, pas kthimit nga Interi në vitin 2009, ku fitoi 4 "Scudetto", 2 Kupa të Italisë dhe një Superkupë Itale, arriti të kurorëzohej kampion në kampionatin brazilian me Flamengo. Karriera e tij në Evropë përfundoi pak përpara sezonit historik të "tripletës" me Mourinhon. Kjo ndeshje e veçantë do të organizohet nga

MTR7, një kompani sportive e fokusuar te futbollit, në partneritet me "MCASport" dhe studion ligjore "Diogo Souza". Ajo është konceptuar për të kurorëzuar një karrierë që do të mbetet në kujtesën e tifozëve. Adriano ka theksuar rëndësinë e këtij momenti: "Edhe pse kam ndalur prej disa vitesh, më duhet kjo ndeshje për ta mbyllur karrierën time. E ndiej si detyrim karshi gjithë atyre që më kanë mbështetur dhe vazhdojnë ta bëjnë". Në këtë ndeshje, Adriano pritet të luajë një pjesë me Flamengo dhe tjetrën me Interin, duke bashkuar dy kapituj të

Dy supersfida në Ligën e Kombeve: Itali - Gjermani dhe Holandë - Spanjë

Nion, 22 nëntor - Është hedhur në Nion të Zvicrës shorti i çerekfinaleve të këtij edicioni të Ligës së Kombeve. Goglat kanë dhuruar përballje interesante, ku spikat supersfida Itali - Gjermani. U hodh edhe "truga" për në finale. Fituesja Itali - Gjermani do të përballë në gjysmëfinale me fituesen Danimarkë - Portugali, ndërsa fituesja e sfidës Kroaci - Francë ndaj fitueses së takimit Holandë



- Spanjë. Çerekfinalet do të luhen në mars të vitit 2025, ndërsa finalët (Final 4) në qershor të vitit 2025.

LIGA E KOMBEVE, SHORTI I ÇEREKFINALEVE

Holandë - Spanjë
Kroaci - Francë
Danimarkë - Portugali
Itali - Gjermani

SHKURT

Kosova i zhvillon dy miqësore me Estoninë në Prishtinë

Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore kundër Kombëtares së Estonisë, më 29 nëntor e 2 dhjetor. Të dyja ndeshjet do të luhen në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, në orën 13:00. Grumbullimi i ekipit të Kosovës do të fillojë më 25 nëntor, ku futbollistët dhe stafi do të akomodohen në hotel "Star Hill". Ndërkohë, seanca e parë stërvitore e "dardaneve" do të zhvillohet më 26 nëntor në Kampin Nacional në Hajvali, duke filluar nga ora 11:30. Këto dy ndeshje miqësore do të jenë një mundësi e mirë për përzgjedhësin Sami Sermexhaj që t'i vazhdojë përgatitjet dhe ta forcojë ekipin për sfidat e ardhshme ndërkombëtare.

Guardiola vazhdon kontratën me Cityn

Trajneri Pep Guardiola do të jetë në krye të Manchester Cityt deri në vitin 2027. 53-vjeçari iu bashkua Man Cityt në vitin 2016 dhe deri tani, ka fituar 18 trofe, prej tyre gjashtë herë Ligën Premierë. Kontrata e tij skadonte në fund të këtij edicioni, por ai vendosi të vazhdojë me klubin e elitës angleze. "Manchester City ka kuptim të madh për mua. Është edicioni i nëntë i imi këtu. Kemi përjetuar shumë gjëra të mira bashkë këtu. Kam ndjenja të veçanta për këtë klub. E kam thënë edhe më herët, këtu kam çdo gjë që një trajner mund të kërkojë dhe këtë e vlerësoj shumë. Shpresoj të fitojmë më shumë trofe. Ky është synimi im", ka thënë Guardiola. Pep Guardiola e bëri Manchester Cityn vetëm skuadrën e dytë angleze që e fiton "tripletën", kur triumfoi në Ligën Premierë, FA Cup dhe Ligën e Kampionëve, në të njëjtin edicion.

Federata i ofron kontratë të re Nagelsmannit

Në Federatën Gjermane të Futbollit duken të dashuruar pas Julian Nagelsmannit. Ish-trajneri i Bayern Munchenit erdhi si një zgjidhje e shpejtë pas largimit të Hansi Flickut, por brenda një periudhe shumë të shkurtër, Nagelsmann e ktheu Gjermaninë në një skuadër që zhvillon një futboll të bukur ofensivë. Me të në stol, shkuan deri në çerekfinalet e "Euro 2024", por nëse nuk do të ishte për Spanjën dhe atë dorë të Cucurellas gjërat mund të shkonin ndryshe. Më 16 prill të këtij viti, Federata Gjermane njoftoi rinovimin e kontratës me Nagelsmann deri në Botërorin e 2026 por, sipas "Bild", Federata kërkon të nënshkruajë menjëherë një kontratë të re me Nagelsmannin. Gjithnjë sipas "Bild", Federata Gjermane është e gatshme ta rinovojë kontratën me të deri më 2028. Edhe Nagelsmanni është i kënaqur me këtë aventurë në stolin e ekipit përfaqësues dhe pritet t'i thotë "po" edhe ofertës së re.

Fenerbahçe synon ta rikthejë Ronaldon në Evropë

Një klub po përpiqet ta kthejë Cristiano Ronaldon në Evropë. Sipas portalit turk "Fotomac", Fenerbahçe shpreson ta bindë Cristiano Ronaldon të kthehet në Evropë pas dy viteve të kaluara në Arabinë Saudite.

Jose Mourinho, i cili ka punuar me portugezin te Real Madridi, thuhet se tashmë ka folur personalisht me Ronaldon për ta bindur që të kalojë në Fenerbahçe. Mario Branco, drejtori sportiv i Fenerbahçes, gjithashtu do të

kishte ndërmarrë hapa konkretë për ta bërë transferimin një sukses dhe ka nisur tashmë bisedimet me Al-Nassrin për lëvizjen që do të ndodhte në janar. Jose Mourinho është optimist se transferimi mund të

realizohet dhe beson se agjenti Jorge Mendes, i cili menaxhon të dy, do të luajë një rol vendimtar. Cristiano Ronaldo mbërriti në janar 2023-s tek Al-Nassri dhe me këtë transferim u bë futbollisti më i paguar në botë, me një

pagë vjetore prej 200 milionë eurosh. Individualisht Cristiano Ronaldo pati arritje të jashtëzakonshme në Arabinë Saudite, 68 gola dhe 18 asistime në 79 ndeshje, por nuk arriti ta fitojë kampionatin me Al-Nassrin.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Rizam Holding” Sh.p.k. Mamushë, Prizren në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për shtimin e kapaciteteve për prodhimin e bllokave dhe elementeve tjera te ndërtimit qe dalin nga argjila në Piranë, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.01.2025 në ora 10:00 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Xhevat Berisha” Adresa: Rr.Xhevat Berisha pn, Lagjja Tusuz, Prizren do të organizohet debat publik nga Kompania “Rizam Holding” Sh.p.k. Mamushë, Prizren në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2ViLnpyb20udXMvai80NTQ5MzQ0NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjUl1d4MzlGM2U4UUUY3UHNBa0NNM2J2SzYuMQ==&i=NjQ1Y2I1MTQyMmJwZTM3YjNiOGQ4Y2Ix&t=YkZxNVAxTIRhRzFCQUFJSmlwS1pwUTZoOUZFUmcxQzFSeVM2T3RacG1FUT0=&h=7260f6ca610c44b5b762d8543a94261a&s=AVNPUeHUT0NFTkNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55_29at16bUHiQ

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Rizam Holding” Sh.p.k. Mamushë, Prizren për impiantin për shtimin e kapaciteteve për prodhimin e bllokave dhe elementeve tjera te ndërtimit qe dalin nga argjila në Piranë, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Eurovizion” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811335175 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Eurovizion” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811335175 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Eurovizion” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811335175 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albion Elshani shpall të pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Bardh Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Enrik Shtufi shpall të pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Arilon Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat enkl VI - IX shfmu “ Brigada 125 “ Medvec.

- Pranvera Minci shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Fadil Hisari “ Prizren.

- Flandra Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi “ Prizren.

- Artan Quni shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Leke Dukagjini “ Prizren.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me

sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë.

Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA 1992

